



Breaking News:

Sarandë – Vihen në pranga 2 shtetas, për vepra të ndryshme penale



Lajmet

11/04/2023

DVP Dibër – Vihen Në Pranga 2 Shtetas, Procedohet Në Gjendje Të Lire 1 Tjetër

DVP Dibër/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohet në gjendje të lire 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Bulqizë arrestuan në flagrancë shtetasin U. T., 45 vjeç, banues në Bulqizë, pasi ka ushtruar dhunë ndaj vëllait të tij.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve të DVP Dibër, në vijim të punës hetimore të kryer në drejtimin e Prokurorisë së Dibrës, me fokus evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve, vunë në pranga shtetasin V. M., 27 vjeç, banues në Durrës, pasi nga veprimet hetimore ka rezultuar se në bashkëpunim me shtetas të tjerë, ka qenë i përfshirë në një rast të shitjes së lëndëve narkotike, të goditur më parë. Vijnë hetimet me qëllim dokumentimin ligjor të përgjegjësisë penale të 27-vjeçarit, si dhe për identifikimin dhe vënien në pranga të bashkëpunëtorëve të tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Mat referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi në gjendje të lirë për një 17-vjeçar, pasi gjatë kontrollit fizik i është gjetur një pistoletë shenjëdhënëse.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

◀ Sarandë – Vihen në pranga 2 shtetas, për vepra të ndryshme penale

Kakavijë – Inaugurohet Qendra e Bashkëpunimit Policor dhe Doganor Kakavijë, Greqi-Shqipëri ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)